



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. _____

Tiranë ____/____/2026

VENDIM

Nr. 8, datë 19.03.2026

PËR
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE
NË VENDIMIN QARKULLUES
TË KËSHILLIT DREJTUES NR. 26, DATË 30.09.2020
“MBI MIRATIMIN E STRATEGJISË TË ZHVILLIMIT DHE TË MENAXHIMIT
TË BURIMEVE NJERËZORE
NË AGJENCINË E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 9, pika 3 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 6/1, shkronja “e” të Rregullores nr. 20, datë 25.09.2017 “Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 31 datë 10.10.2025 “Për caktimin e Z. Martin Blushi, zëvendës drejtor i përgjithshëm, për të ushtruar kompetencat për mbarrëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, deri në emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm”, të nenit 18 pika 2 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014, si dhe me propozim të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

I. Në vendimin qarkullues të Këshillit Drejtues nr. 26, datë 30.09.2020 “Mbi miratimin e strategjisë të zhvillimit dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave” të bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në objektivin “3. Zhvillimi i aftësive profesionale nëpërmjet përfitimit të ekspertizës nga partnerët strategjikë dhe palët e treta”, emërtimi dhe përmbajtja e iniciativës “Zhvillimin e njohurive dhe kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore të Agjencisë sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira



AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit, Nr. 317
Tiranë / Albania
t: +355 (4) 2362 989/2347 298 f: +355 (4) 2362 984
e: info@asd.gov.al w: www.asd.gov.al



në fushën e sigurimit të depozitave” zëvendësohet me emërtimin dhe përmbajtjen e mëposhtme:

“Zhvillimi i kapaciteteve profesionale për harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian dhe ato ndërkombëtare

Për arritjen e kësaj iniciative, Agjencia synon të ndërtojë dhe të konsolidojë një qasje të integruar për zhvillimin dhe rritjen e qëndrueshme të kapaciteteve të burimeve njerëzore. Forcimi i kapaciteteve të stafit konsiderohet një komponent thelbësor për garantimin e qëndrueshmërisë institucionale dhe rritjen e efektivitetit në administrimin e skemës së sigurimit të depozitave, nëpërmjet marrjes së masave të mëposhtme:

i) Forcimi i kapaciteteve profesionale në kuadër të harmonizimit me standardet e Bashkimit Evropian

Në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe të përmbushjes së kërkesave për përafrim me acquis të BE-së, një fokus i veçantë do t'i kushtohet përgatitjes së stafit mbi kuadrin rregullator të BE-së në fushën e sigurimit të depozitave, në përputhje me Direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave”.

Për këtë qëllim, fokusi do të jetë angazhimi i secilit sektor të Agjencisë në analizimin e acquis të BE-së në lidhje me sigurimin e depozitave, sipas çështjeve përkatëse, dhe shpërndarja e konkluzioneve me njësitë e tjera organizative. Një element i shtuar në këtë drejtim është edhe ndërveprimi me skemat homologe evropiane të sigurimit të depozitave për shkëmbimin e eksperiencave me to, nëpërmjet vizitave studimore dhe takimeve dypalëshe ose trajnimeve on-line. Zbatimi i kësaj iniciative do të mundësojë harmonizimin e praktikave institucionale me standardet evropiane dhe rritjen e kapaciteteve teknike për zbatimin efektiv të tyre.

Agjencia do të synojë përfshirjen në instrumentet e asistencës teknike të financuar nga BE për vendet kandidate me qëllim implementimin e reformave ligjore të fazës së paraanëtarësimit në BE. Gjithashtu, Agjencia do të angazhohet edhe në kualifikimin e punonjësve të saj pranë strukturave të Bashkimit Evropian, në rastet kur kjo është e mundur.

ii) Rritja e pjesëmarrjes në programet e trajnimit ndërkombëtar.

Agjencia do të intensifikojë përfshirjen e punonjësve në trajnime, konferenca dhe programe zhvillimore të ofruara nga organizatat ndërkombëtare ku ajo aderohet, veçanërisht në Forumin Evropian të Skemave të Sigurimit të Depozitave (EFDI) si dhe Shoqatën Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI). Përzgjedhja e trajnimeve do të fokusohet në programe të specializuara që mbështesin drejtpërdrejt prioritetet strategjike të Agjencisë. Gjithashtu do të sigurohet transferimi i njohurive të përfituara, përmes mekanizmave të brendshëm të shpërndarjes së njohurive të marra nëpërmjet këtyre trajnimeve.

Në kuadër të objektivave strategjike të Agjencisë për forcimin e kapaciteteve





profesionale dhe harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian, një rol thelbësor zë intensifikimi i pjesëmarrjes së stafit në aktivitetet, trajnimet dhe programet zhvillimore të ofruara nga Forumi Evropian i Skemave të Sigurimit të Depozitave (EFDI). Gjithashtu, Agjencia do të synojë që të angazhojë punonjësit e saj në grupet e punës të EFDI-t për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të drejtpërdrejtë në diskutimin, zhvillimin dhe përditësimin e praktikave më të mira të skemave homologe të vendeve anëtare të BE-së, duke përfutur ndër të tjera njohuri mbi proceset e kompensimit të depozitave, vlerësimin e riskut, financimin e skemës, si dhe menaxhimin e krizave bankare. Ky mekanizëm do të rrisë aftësinë e institucionit për të zbatuar kërkesat teknike dhe rregullatore të procesit të integritetit evropian. Në këtë mënyrë, pjesëmarrja aktive e stafit të Agjencisë në grupet e punës të EFDI-t përbën një mjet të rëndësishëm për zhvillimin profesional dhe modernizimin e veprimtarisë të saj.

Masat e mësipërme do të kontribuojnë në fuqizimin e kapaciteteve teknike si dhe vendimmarrëse për realizimin efikas të funksioneve të Agjencisë, veçanërisht në rast ngjarje sigurimi, ku rrethanat kërkojnë një reagim të shpejtë, profesional dhe të koordinuar.”

1. Në tabelën e objektivave dhe iniciativave strategjike, emërtimi i iniciativës “Zhvillimi i njohurive dhe kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore të Agjencisë sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira në fushën e sigurimit të depozitave” zëvendësohet me emërtimin “Zhvillimi i kapaciteteve profesionale për harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian dhe ato ndërkombëtare”.

II. Ngarkohet Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

III. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Donald Duraj

Shqipe Malaj

Kryetar

Sekretare

